



Data: 29.03.2023
Nr. Prot. 29/23
Drejtuar: Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Lënda: Ankim administrativ ndaj vendimit të KZAZ
Baza ligjore: Nenet 68, 73, 124 dhe 126 i ligjit Nr. 10 019, datë 29.12.2008 (i ndryshuar), Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë si dhe neneve 130 dhe 131 të ligjit 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative të RSH.

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve

Në respektim të nenit 124 të Kodit Zgjedhor Kodit Zgjedhor po ju drejtojmë këtë ankim administrativ ndaj vendimit Nr.10, datë 28.03.2023, ora 21:23, të KZAZ-së Nr.82 në Bashkinë Dropull të rrethit Gjirokastrë.

Në respektim të Nenit 126 të Kodit Zgjedhor po ju përshkruajmë argumentet kundër këtij vendimi, si dhe po ju bashkangjism faktet tek të cilat bazohet ky ankim.

Me datë 27 Mars 2023, subjekti Partia Nisma Thurje paraqiti dokumentacionin për tu regjistruar në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023 për organet e qeverisjes vendore, duke paraqitur një kandidat për kryetar bashkie. Ky pohim vërtetohet nga procesverbali li dorëzimit të dokumenteve të kandidimit, i cili është marrë në dorëzim Gligor Dushi, në cilësinë e kryetarit të KZAZ-së, me datë 27.03.2023. Nëse zoti Dushi do të kishte konstatuar mungesë dokumentacioni, ajo do të ishte paraqitur në këtë procesverbal. Por qartazi, Z. Dushi nuk ka paraqitur asnjë pretendim për mungesë dokumentacioni.

Së dyti, edhe në vendimin Nr.10 të KZAZ Nr.82, nuk është justifikuar mos regjistrimi i kandidatit Kosta Garo, duke mos dhënë asnjë argument përse anëtarët e KZAZ-së kanë vendosur që subjekti Partia Nisma Thurje të mos regjistrohet në këto zgjedhje. Për këtë mjafton të shikoni një kopje të vendimit bashkangjitur kësaj kërkesë, ku nuk ofrohet asnjë argument apo shpjegim i këtij vendimi.



Së treti, edhe në rast se KZAZ do të kishte vërejtur parregullsi, sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor (Neni 73), subjektit zgjedhor do duhej t'i kërkohej plotësimi i dokumentacionit, gjë e cila nuk ka ndodhur.

Për këtë arsye, po paraqesim përpara jush kërkesën për regjistrimin e Z. Kosta Garo si kandidat për kryetar bashkie i subjektit Partia Nisma Thurje në zgjedhjet e 14 Majit 2023 për organet e qeverisjes vendore të bashkisë Dropull. Për këtë qëllim do paraqesim përpara jush dokumentacionin e kërkuar nga Neni 68 i Kodit Zgjedhor, si më poshtë:

- Procesverbali Model KQZ-00-31 i dorëzimit të dokumentave të kandidimit administruar me datë 27 Mars 2023 nga KZAZ Nr. 82 në Dropull
- Vendim Nr.10 datë 28.03.2023 i KZAZ-së Nr.82
- Kërkesë për regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie Model KQZ 04-06, për bashkinë Dropull
- Deklaratë e kandidatit Kosta Garo për hapje llogarie bankare të posaccme, model KQZ 04-08, për zgjedhjet e datës 14 Maj 2023 për organet e qeverisjes vendore
- Deklaratë Model KQZ 04-09 për pranimin e kandidimit për kryetar bashkie i bashkisë Dropull nga kandidati Kosta Garo
- Formulari model KQZ04-10 – jetëshkrimi i kandidatit Kosta Garo
- Formulari tip i vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar të bashkisë Dropull Kosta Garo, për zgjedhjet e organet e qeverisjes vendore
- 15 faqe të formularit Model KQZ 04-01 për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve për mbështetjen e kandidatit Kosta Garo. Në total nënshkrimet e 215 votuesve të bashkisë Dropull.
- Fotokopje e 215 kartave të identitetit të nënshkruara nga votuesit e bashkisë dropull, të identifikuar në formularët Model KQZ 04-01.
- Fotokopje e nënshkruar e kartës së identitetit të kandidatit Kosta Garo
- Autorizim i kryetarit të partisë së Partisë Nisma Thurje për Kosta Garon që të dorëzojë dokumentacionin në KZAZ-në Nr. 82

Kosta Garo

Kandidat për kryetar i bashkisë Dropull

Dr. Endrit SHABANI

Kryetar i Partisë

Partia Nisma Thurje

